



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 161/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevcu duke vendosur përkitazi me ankesat e Ali Tafarshiku, Iniciativës Alternativa, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterave në hapsirë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

VENDIM

LEJOHET tërheqje e ankesave e Ali Tafarshiku-ALTERNATIVA, Anr.161, Anr.162, Anr.163, Anr.164 dhe Anr.165, të datës 08.06.2017.

Arsyetim

Ali Tafarshiku -ALTERNATIVA, Gjakovë, ka paraqitur gjashtë ankesa në PZAP kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterave në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me datë 09.06.2017 ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr.161, Anr.162, Anr.163, Anr.164, dhe Anr.165, duke u bazuar në faktin se koalicioni LDK-AKR nuk ka prova shtesë për ti ofruar PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 161/2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.